



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria për Prokurim Publik

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. “SOLVIT shpk” me seli në Prishtinë, kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues – Drejtoria për Prokurim Publik për Dhënie të Kontratës të publikuar me dt.14.08.2023, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 10 paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenin 8 pika 8.1.2 paragrafi i të Rregullave për paraqitje të Kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, me datën 24.08.2023 merr këtë:

V E N D I M

1. **Aprovohet si pjesërisht e bazuar Kërkesa për rishqyrtim, e subjektit në procedurë: “SOLVIT shpk” me seli në Prishtinë, e datës 15.08.2023, për rishikimin-rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit kundër Vendimit mbi Njoftimin e Autoritetit Kontraktues të datës 14.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi me tabela smart dhe Teknologji Informative”, Nr.Prokurimi: VU644-23-7254-1-2-1, Nr. i brendshëm: VU644-23-084-121.**
2. Autoritetit Kontraktues – Drejtoria për Prokurim Publik, në pajtim me dispozitat e nenit 108/1 paragrafi 10.2 të LPP-së do të vazhdoj me rivlerësim të aktivitetit të prokurimit.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme A.K.) në bazë të rezultatit nga procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve ka marrë vendim që ta rekomandoj për dhënie të kontratës për aktivitetin: “Furnizimi me tabela smart dhe Teknologji Informative”, me Nr.Prokurimi: VU644-23-7254-1-2-1, Nr. i brendshëm: VU644-23-084-121, ta shpërblejë me kontratë OE “Infinit” shpk & “KIGA” shpk me seli në Prishtinë, ndërsa O.E.: “SOLVIT shpk” me seli në Prishtinë, (në tekstin e mëtejme Ankuesin) ta radhit në mesin e O.E. të pasuksesshëm, bazuar në procedurën e zbatuar.

Në Kërkesën për rishqyrtim parashtruar nga Op. Ek. “SOLVIT shpk” me seli në Prishtinë, (në tekstin e mëtejme Ankuesi), e cila është parashtruar brenda afatit të paraparë ligjor, parashtruesi i Kërkesës konsideron se me këtë rast janë shkelur dispozitat e LPP-së, nenet 1, 7, 59 dhe 60.

Ankuesi pretendon se:

1. Grupi i OE i rekomanduar nuk është i përgjegjshëm në aspektin teknik, sepse nuk ka ofruar produktet e kërkuara sipas kërkesave të DT dhe Njoftimit për kontratë.
Lidhur me pretendimin nr.1, AK konfirmon se OE e rekomanduar ka përmbushur këtë kriter, pasi që i njëjti ka ofruara produktet e kërkuara sipas kërkesave të DT dhe Njoftimit për kontratë, prandaj **ky pretendim nuk qëndron.**
2. Grupi i OE i rekomanduar nuk ka ofruar stafin e certifikuar për konfigurim të pajisjeve dhe trajnim të mësimdhënësve.
Lidhur me pretendimin nr.2, AK konfirmon se një kërkesë e tillë nuk është pjesë e FTD-së, prandaj **ky pretendim nuk qëndron.**
3. Te Grupi i OE i rekomanduar specifikimet teknike nuk përshtaten me kërkesat e AK-së në Dosjen e Tenderit.
Lidhur me pretendimin nr.3, AK konfirmon se OE e shpërblyer nuk ka përmbushur këtë kriter, sepse OE e rekomanduar ka modifikuar specifikimet teknike në katalogun bazik - original, prandaj **ky pretendim qëndron.**

Pasi u shqyrtuan pretendimet e Ankuesit të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim dhe vlerësimin të provave në shkresat e lëndës, u konstatua se Kërkesa për Rishqyrtim e Ankuesit është pjesërisht e bazuar.

Lidhur me pretendimin e Ankuesit se O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës tek “Specifikat teknike” për pajisjet e ofertuara nuk i plotëson specifikat e kërkuara në Dosjen e Tenderit, pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara.

Prandaj A.K. këto pretendime i konsideron si të qëndrueshme, dhe çështjet e ngritura do t'i marrë në rishqyrtim gjatë procesit të rivlerësimit të tenderit në fjalë.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë
K.R.. nr. 084/2023, datë 15.08.2023

Drejtori i Drejtorisë për Prokurim Publik



Alban Tahiraj

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë Vendim ka të drjtë të parashtrij Ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim – OSHP-së, në pajtim me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Vendimi i dërgohet nga një kopje:

1. Palës/ ve;
2. DPP-së, dhe
3. Arkivit.